



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 3, datë 10.01.2025

PËR

**“MIRATIMIN E OPINIONIT PËR KANDIDATEN QË KA APLIKUAR NË
PROCEDURËN E KOMANDIMIT SI KËSHILLTAR LIGJOR PRANË KËSHILLIT TË
LARTË TË PROKURORISË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
9. Zotit Erind GËRMENJI	Anëtar (në mungesë)
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Zoti Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 10.01.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e opinionit për kandidaten që ka aplikuar në procedurën e komandimit si këshilltar ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
2. Neni 53 pika 1 dhe 2, të ligjit nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar*;
3. Nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar*.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues nr. 46 prot., datë 10.01.2025, i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës;
- ii. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

- 1- Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 pikat 1 dhe 2, 54 pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit Nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar*, me vendimin nr. 224, datë 23.10.2024, ka miratuar fillimin e procedurave për plotësimin e një pozicioni Këshilltar Ligjor, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përmes procedurës së komandimit, për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
- 2- Njoftimi për shprehjen e interesit për pozicionin e shpallur u publikua në faqen zyrtare web të Këshillit. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së njoftimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me afatin fundor të aplikimit për kandidatët e interesuar datën 12.11.2024, ora: 24:00. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë paraqitur tre kërkesa.

Kriteret e kërkuara për këtë pozicion janë si më poshtë:

- të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- të ketë ushtruar profesionin e magistratit për të paktën 5 (pesë) vite;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambjentale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Sekretarin e Përgjithshëm ose prokurorët e tjerë të komanduar në Këshill, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të ligjit nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarot dhe rokurorit në republikën e Shqipërisë”*.

Dokumentacioni i kërkuar ishte si më poshtë :

- Letër motivimi ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy faqe A4);

SEKRETA

- CV- në e përditësuar të kandidatit;
 - Deklaratën e papajtueshërisë ambjentale;
 - Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm në funksion të këtij kandididimi.
- 3- Më datë 12.11.2024 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurores Pranvera Gruda, e cila është e emëruar në funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
- 4- Nga verifikimi, pas përfundimit të afatit, u verifikuan kriteret dhe rezultoi se kandidatja Pranvera Gruda e cila ka aplikuar brenda afatit, është prokurore e Republikës së Shqipërisë dhe ka ushtruar profesionin e magjistratit për të paktën 5 (pesë) vite.
- 5- Gjithashtu, zonja Gruda nuk është në kushtet e papajtueshmërisë ambjentale dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- 6- Nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e kandidates rezulton se Pranvera Gruda, ka rreth 35 (tridhjetë e pesë) vjet vjetërsi pune. Zonja Gruda ka ushtruar funksionin e magjistratit që prej vitit 1989 deri në maj të vitit 2001 dhe nga 11.10.2019 e në vijim (vendim nr. 212 datë 11.10.2019 i KLP-së). Nga qershori i vitit 2001 deri në maj të vitit 2011, ka mbajtur pozicionin e inspektore pranë Ministrisë së Drejtësisë. Nga maji i vitit 2011 deri në tetor të vitit 2019, ka mbajtur pozicionin e ndihmëses ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme. Nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se:

- 7- Nisur nga sa më sipër, pavarësisht situatës së sistemit të prokurorisë për shkak të vakancave që aktualisht arrijnë në 35%, vlerëson se funksioni i prokurorëve të komanduar në Këshill është tejet i rëndësishëm, pasi lidhet me procesin e vlerësimit periodik etiko-profesional të prokurorëve.
- 8- Në kushtet kur magjistrati i komanduar si Këshilltar Ligjor pranë KLP-së do të angazhohet me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional në bazë të ligjit, Këshilli pasi ka verifikuar plotësimin e kriteve ligjore sipas legjislacionit në fuqi dhe shpalljes, kualifikon kandidaten Pranvera Gruda, në këtë procedurë dhe për vlerësimin e kriteve specifike të kandidatëve, e kalon për vijimin e procedurës në Komisionin e Vlerësimit Etik dhe Profesional.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 53, pikat 1 dhe 2 dhe nenin 54 pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit Nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2 dhe 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e opinionit për prokuroren Pranvera Gruda, kandidate për t'u komanduar si Këshilltar Ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Ky vendim, opinionit bashkëlidhur dhe të gjitha dokumentet e paraqitura nga kandidatja Pranvera Gruda, i përcillen për vijimin e procedurave të mëtejshme, Komisionit të Vlerësimit, Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.01.2025.



KRYETAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Arta Mandro

ANËTAR

Vatë Staka

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Olger Eminaj

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR

Erion Fejzulla